



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 145/14
Prishtinë, më 5.03.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Musafa, Albana Fetoshi, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Naim Fetahu - zv.Ministër i Financave, Hasan Isufi zv. drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Shemsi Veseli – zv.Ministër i Shëndetësisë, Arianit Jakupi - Kryeshef nga AKPM, Banush Pacolli zv. Ministër i Infrastrukturrës Avdi Kamerolli, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administra e Kuvendit, Aleksandra Fehlinger dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Syl Ahmeti – gazetar nga Kosova Sot.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.02.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 5. Shqyrtimi i Raporti të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja: propozojë që rendi i ditës të plotësohet me një pikë të re: Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve,

Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre , me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Komisioni që deri me 10.03.2014, të jap raportin me rekomandime.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës njëzëri miratohet me plotësime, si në vijim: Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si pika e gjashtë me radhës e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.02.2014

Kryetarja: konstatoi se procesverbali miratohet njëzëri.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Shemsi Veseli: sqaroi se projektligji është vlerësuar se do të ketë kosto shtesë buxhetore rreth 300,100€, por se në të njëjtën kohë gjeneron të hyra në shumë prej 350,100 €, që do të thotë se të kemi 40,000€ shtesë për buxhetin e Kosovës. Unë mëndo që kërkesa jonë është e arsyeshme sepse kemi të bëjmë me cilësi të reja të shërbimeve të reja. Ne kemi ardhur në përfundim se rritja e numrit të punëtorëve është e domosdoshme, pasi që do të ofrojmë shërbime të reja dhe kjo lidhet me funksionalitetin e laboratorit.

Kryetarja: theksoi se deklarata financiare e projektligjit është bërë në vitin 2012, po më intereson me ditë a është përfshi diçka nga kjo kosto buxhetore në kuadër të buxheti të vitit 2014?

Shemsi Veseli: sqaroi se në buxhetin e vitit 2014, nuk është përfshirë kostoja shtesë buxhetore e vlerësuar për zbatimin e këtij ligji.

Kryetarja: sqaroi se tani nuk mund të ndahet buxhet shtesë, pasi që buxheti është miratuar, dhe kjo mund të ndodhë në rishikim të buxhetit. Kostoja buxhetore shtesë nuk është ndonjë shumë e madhe, dhe ndoshta në këtë fazë mund të gjinden mjetet brenda ministrisë së shëndetësisë, që të krijohen rrethanat për fillimin e implementimit të ligjit.

Muhamet Mustafa: pyeti, shuma prej 350,000€ që janë të ardhura, a janë duke u inkasuar edhe tani, sa keni përfitime prej shërbimeve?

Arianit Jakupi: njoftoi se Agjencia funksionon dhe punon me kapacitete të kufizuara dhe numri i shërbimeve që ne mund ti japim do të ishte shumë më i madh në krahasim me atë që tash kemi.

Shemsi Veseli: laboratorit ka punuar po nuk ka qenë funksional sa duhet, prandaj duke e parë se është shërbim, kërkon rritje të numrit të punëtorëve.

Hykmete Bajrami: ajo që mendoj unë është se kur ka shërbime shtesë ka edhe kosto shtesë. Përmes këtij projektligji gjenerohen të hyra shtesë, dhe që nuk mbulohet tani duhet të parashikohet në buxhetin e ardhshëm. Disa shërbime janë shumë të rëndësishme që kur ti bëjmë analizat kosto-benefit, benefitet dalim më të mëdha sa që mendojmë edhe ne.

Arianit Jakupi: njoftoi se në procesin e akreditimit të laboratorit me ISO standarde dhe e kemi në proces

final para aplikimit. Me këtë rast kërkohet edhe me standarde nderkombëtare, është bërë organogram i ri që parasheh staf të ri me krye analizat të cilat faktikisht nuk kryhen. Në departamentin ku bëhet regjistrimi i produkteve medicinale nuk bëhet regjistrimi i produkteve herbiale, nuk bëhet regjistrimi i klasifikimit të produktit ATC si dhe produktet homopatike të cilat janë shërbime të reja të cilat ofrohen. Në departamentin e licencimit edhe me strategjinë e qeverisë për narkotik është prapare krijimi i departamentit për narkotik i cili do të kishte së paku 3 persona. Në procesin e farmakovigilancës që është për evidentimin e veglave anësore të produkteve medicinale në të gjitha institucionet shëndetsore por edhe nga pacientët janë vetëm dy zyrtarë, e parashihen të jenë së paku 5 zyrtar.

Kryetarja: ne mund të kalojmë projektligjin dhe qështje e të punësuarve le të rregullohet në kuadër të buxhetit të ministrisë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale përmabn kosoto buxhetore shtesë, që është e përbalueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kërkesat për rritjen e numrit të të punësuarve të paraqitura në deklaratën financiare të projektligjit, të mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2014. Amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmabjnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja: thekson se është e informuar se kjo pikë është shqyrtuar në mbledhjen e fundit, por pasi që ka kosto shtesë është shtyer për këtë mbledhje. Është një ligj shumë i rëndësishëm që del si obligim i Kuvendit nga MSA, për këtë e kemi edhe shkresën nga komisioni funksional.

Latif Gashi: sqaroi se është shty shqyrtimi i Projektligjit për shkak se materialin e kemi marrë me vonesë.

Hykmete Bajrami: unë sinqerisht kisha dasht me ditë apo falsim për koston buxhetore të amendamenteve apo për koston buxhetore të projektligjit. Nëse është kostoja buxhetore e projektligjit, është dashur që ky projektligj me u diskutu në brenda kabinetit qeveritar, e sot ne si komision për buxhet e finanacë mos të merremi me këtë. Ministrinë është dashur të merren vesh mes veti pa ardhë projektligji në kuvend.

Kryetarja: theksoi se amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë, ndërkaq projektligji është vlerësuar se përmban kosto buxhetore shtesë. Është mirë me e diskutu me dy zëvendës ministrat, si janë mundësitë buxhetore, a mundemi me i plotësue këtë kriter, në mënyrë që të dalim mirë në MSA.

Banush Pacolli: sqaroi se shërbimet e Navigacionit ajror aktualisht janë në kuadër të pjesës publike të aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të transformohen në agjensi për shërbimet e navigimit ajror. Parashihet të krijohen të hyra të dedikuara që për vitin 2014 janë vlerësuar 2.5 milion euro dhe kjo varet nga fluturimet e avionëve në hapësirën ajrore të Kosovës. Shpenzimet tjera sipas kategorive janë paraqitur në deklaratën financiare.

Avdi Kamerolli: thekson se parimisht ky projektligj parashihet në raportin e progresit si obligim i Kosovës për me e themelue këtë agjension. Deri më tash shërbimet e navigimit ajror janë ushtruar në kuadër të pjesës së mbetur të aeroportit nderkombëtar të Prishtinës. Agjencia parashihet të vetëfinancohet përmes të hyrave të dedikuara. Për shkak se Agjencia trashigon infrastrukturën komplete, i trashigonë edhe kapacitetet njerëzore aktuale që janë aty. Kërkesa për mjete shtesë kapitale ka ardhur si rezultat i një takimi të NATO-së që është kërkuar nga shtetet e rajonit për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore. Në deklaratën financiare janë paraparë edhe të hyrat që do të krijohen nga hapësira e lartë ajrore, por se duke pasur parasysh faktin se këtë hapësirë e kontrollon Hungaria, nuk do të kemi të hyra nga hapësira e lartë ajrore.

Muhamet Mustafa: unë mendoj se ky agjencion është shumë i rëndësishëm, por ne duhet të jemi të kujdesshëm me i harmonizue kërkesat me mundësitë buxhetore dhe kërkesat duhet të realizohen hap pas hapi. Meqë stafi aktual i aeroportit që ka kryer këtë shërbim kalon në agjenci, në këtë vit të shikojmë se çka ka nevojë për shpenzime shtesë kapitale, e mos me shkue menjëherë me kërkesa të larta buxhetore.

Latif Gashi: pyeti për të hyra e dedikuara, a është fjalal për të hyra vetanake për agjencionin apo si është menduar të shfrytëzohen këto të hyra?

Avdi Kamerolli: sqaroi se të hyrat që do të krijon agjencionin (vajtje-ardhje), shkojnë në ministrinë e financave dhe dedikohen për agjencionin. Nëse krijohen të hyra më të mëdha, ato mund të shfrytëzohen për projekte kapitale. Gjatë gjithë vitit ka pas rritje të investimeve në sektorin e aviacionit civil dhe rritje të udhëtarëve dhe për çdo vit ka pas rritje për 10% të udhëtarëve.

Hykmete Bajrami: njoftoi se ka pasur rastin të bisedoj me përfaqësuesit e kompanisë së aeroportit e cila ka mbetur pa u dhënë me koncesion, para se të vijë ligji në Kuvend. Ata kanë treguar që operojnë në kushte shumë të vështira dhe një ndër problematikat kryesore është qështja e sigurisë do të thotë se menagjohet kulla prej kësaj pjese e cila pretendohet të shëndrrohet në agjension. Nëse kjo shëndrrohet në agjension është e domosdoshme të blejnë edhe sigurimin, për tu siguruar nga ndonjë fatkeqësi dhe kjo është e rregullme në këtë formë në krejtë botën. Qështja e marrjes në menaxhim të hapësirës ajrore nga ana e Hungarisë duhet të shikohet me një sy kritik, sepse është thënë se në mungesë të investimit prej 25 milion eurove, Kosova e ka humb kontrollin në menaxhimin e hapësirës së saj ajrore. E humbjet vjetore janë të llogaritura prej 10 deri në 12 milion euro, e që sot këto të hyra i shkojnë Hungarisë. Ne duhet të përgaditemi për pesë vite kur na kthehet nën menaxhim hapësira ajrore, dhe mos të ndodhë që prapë kontrollit hungares ti vazhdohet kontrata, po që ka kosto shtesë ky projektligj, shifet qartë se ka.

Naser Osmani: thekson se dilema është se një institucion i cili është në kuadër të ministrisë në formë departamenti siç është sot, nëse kërkohet të shëndrrohet në agjension në kuadër të qeverisë që për nga aspekti buxhetor për mua është pranueshme me përkrah, pasi që mjetet do të siguroheshin nga buxheti, respektivisht mjetet kontigjente të ndara për ministrinë e infrastrukturës për këtë vit.

Kryetarja pyeti sa punëtor aktualisht i ka departamenti i navigacionit ajror ekzistues që parashihet të shëndrrohet në agjencion?

Avdi Kamerolli: sqaroi se parimisht nuk ka me qenë kritike deri në rishikim të buxhetit qështje e financimit, pasi që departamenti ka funksionuar si pjesë e ndërmarrjes publike aeroporti i Prishtinës. Përsa i përket të punësuarve janë të punësuar 150 punëtor.

Naser Osmani: nga sqarimet që u dhanë se drejtori i përgjigjet qeverisë, po shifet se kemi të bëjmë me ndërmarrje publike dhe në bazë të kësaj del se agjencionin është në kuadër të Qeverisë. Prej një statusi që e

keni më të favorshëm ju po shkoni në kuadër të qeverisë, respektivisht në kuadër të ministrisë së infrastrukturës.

Avdi Kamerolli: sqaron se kompetenca e sektorit të aviacionit civil janë të ndara në mes disa subjekteve. Ministria e Infrastrukturës është autoritet për rregullimin ekonomik për aviacionin civil, autoriteti i aviacionit civil është autoritet për rregullimin teknik për aviacionin civil, veprimet operationale i kryen aeroporti nderkombëtar që është dhënë me koncesion. Sigurimin e ka në përgjegjësi ministria e punëve të brendshme, hetimin e incidenteve dhe aksidenteve është e përqëndruar në kuadër të Qeverisë.

Kryetarja: unë kam krijuar një përshtypje se ata që po i bëjnë deklaratat financiare nuk janë duke i bërë mirë, sepse ne duhet të nisemi prej ku jemi e të shkojmë duke u përmirësuar. Kërkohet me u formue agjensioni dhe kërkohen 183 të punësuar për vitin 2014, kjo është absurd i kohës. Departamenti i paska aktualisht 150 të punësuar dhe për vitin 2014 këta punëtor janë të mjaftueshëm me i krye të gjitha punët. Dekalorata financiare nuk është mirë e shkruar sepse nuk janë gjitha këto implikime buxhetore për vitin 2014.

Latif Gashi: unë konsideroj që ngritet niveli i përgjegjësisë sepse aeroporti ka qenë një ndërmarrje publike dhe me dhënien në koncesion, ka mbet një pjesë e saë pa u zgjidhur, dhe ky departament nuk mund ta ketë përgjegjësinë shtetërore pa qenë në kuadër të qeverisë. Qëllimi i ligjit është që të rritet niveli i përgjegjësisë dhe qeveria të merr përgjegjësi për këtë.

Nehat Fetahu: thekson se ne e kemi dhënë mendimin e Ministrisë së Financave për ndikimin buxhetor të këtij PL, mirëpo qeveria ka paraparë rëndësin e këtij projektligji nga obligimet që dalin nga raporti i progresit dhe Kuvendi vendos.

Kryetarja: kërkoj një sqarim nga përfaqësuesit e ministrisë së financave sa i përket nenit 12 që ka të bëjë me të hyrat e dedikuara, a mundet agjencionet që janë në kuadër të ministrisë me pas të hyra të dedikuara?

Hasan Isufaj: sqaron se në pajtim me Kushtetutën që fletë për agjencionet e pavarura dhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, vetëm agjencionet e pavarura që i ka themeluar Kuvendi, mund të kenë të hyra të dedikuara.

Hykmete Bajrami: pse nuk po themi që të hyrat e këtij agjencioni derdhen në buxhetin të Kosovës dhe në bazë të kërkesave ndahet buxheti. Nëse ne themi se të hyrat sigurohen nga tarifa, kjo po i bjen që ato të hyra që i realizon agjencioni të njëjta ka të drejt ti shpenzojë. Pas 4 viteve ne besojmë që Kosova e merr kontrollin e hapësirës ajrore dhe të hyrat rriten shumë më shumë, ndoshta 10 apo 12 milion euro ne vit dhe duhet të kemi parasysh këtë.

Avdi Kamerolli: sqaroi se Kosova për momentin në rast se e kishte marr nën kontroll hapësirën ajrore, përafërsisht parashihet të inkasojë 10 milion euro të hyra brenda vitit, sepse brenda vitit parashihet me fluturu 500 avion.

Latif Gashi: unë konsideroj se është më mirë me thënë se të hyrat derdhen në buxhetin e Kosovës, e agjensioni financohet nga buxheti i Kosovës, nëse jeni të pajtimit kështu, nëse jo e lëmë ashtu siç është.

Kryetarja: se neni 27.3 i projektligjit parasheh se personeli profesional administrativ i aeroportit nderkombëtar të Prishtinës transferohet në agjencion dhe për vitin 2014 do të ketë mjete për funksionim ky agjencion. Ajo që duhet të ndërhyhet është të ndryshohet titulli i nenit 12 në të Hyrat e AshNA, dhe në paragrafin 1 të hiqet fjala “të dedikuara”.

Pas diktimit dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadergjona, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Musafa, Albana Fetoshi, Sevdije Lama dhe Duda Balje), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, përmban implikime buxhetore, por që janë të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligji nr.04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, si në vijim:

Amenamenti 1

Titulli i nenit 12 “Buxheti i ASHNA”, ndryshohet me titullin “Të hyrat e ASHNA”.

Neni 12, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjalët “dedikuara të”, fshihen.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Projektligjin nr.04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Raporti të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

Kryetarja: sqaroi se nga raporti i Kuvendit, përgaditur nga administrata, shohim se buxheti është shpenzuar diku 92.85%. Ajo qfarë më ka bërë përshtypje për disa shpenzime ka disa lëvizje të mëdha nga viti 2012 në vitin 2013, siç është rasti të shpenzimet e naftës për ngrohje, për gjeneratorë, shërbime kontraktuale, mirëmbajtje të ndërtesave. Kërkohej një sqarim për këto lëvizje të mëdha.

Hykmete Bajrami: theksoi se ka qenë në media se deputetët kanë shpenzuar për dreka dhe darka deri në shumën prej 119,000 euro dhe 60,000 euro janë meditet e deputetëve që kanë dalë jashtë shtetit, dhe nuk ka pas asnjë reagim nga ana e administratës së kuvendit, se këto të dhëna janë apo nuk janë të vërteta. Unë nuk kisha dashtë që dikush që ka bërë këto keqpërdorime të mëdha, të njollosohen 120 deputetë që i ka Kuvendi. Nëse informata që i kanë marrë gazetarët janë të pasakta, unë kisha kërkuar nga sekretari që të reagojë kundër deklaratave, dhe gjithashtu kisha kërkuar nga ju kryetare, të reagoni dhe të thoni se nuk janë shpenzimet e komisionit tonë.

Ismet Krasniqi: në raport siç kërket me ligj janë të gjitha të dhënat për shpenzimet të cilat kanë ndodhur gjatë viti 2013, janë të pasqyruara sipas kodeve dhe zërave buxhetor, për të cilat janë lejuar ato mjete. Siç e tha kryetarja, në vitin 2013 janë shpenzuar diku 92.85% e buxhetit, sipas kategorive paga e meditet është shuma 95.53%, mallra dhe shërbime 95.76%, shpenzime komunale 92.68%, subvencionet 99.83% dhe shpenzime kapitale janë 71.16%. Të vetmën paknaqësi që e shprehim si administratë është kontinuiteti i shpenzimeve kapitale, dhe kjo për arsye se procedurat e prokurimit nganjëherë janë të komplikuar dhe nuk po kemi të interesuar për tenderë. Është e vërtetë se ditën e diel me 2 mars, ka dalë një artikull në gazetën Kosova Sot, që është një gazetë që në mënyrë konstante mirret me shpenzimet e buxhetit e me tituj bombastikë, e në përmbajtje kanë qenë të dhënat të cilat janë edhe në material. Por në mbledhjen e kryesisë, të hënën është bërë një reagim, po ashtu një reagim nga ana e kryetarit të kuvendit

për media edhe një reagim në ëeb faqen e kuvendit që është adresu të gjitha mediave, i kemi kontestaur të dhënat që janë paraqitur në artikull.

Istret Azemi: sqaroi se sa i përket shpenzimeve të naftës për ngrohje nga viti 2012, na ka mbetur një borxh prej 380,346 dhe është bartë si shpenzim në vitin 2013. Te pjesa tjetër se sekretari e ceku me herët se në shtator, projekti për blerje të automjeteve e kemi destinu një shumë prej 70,000 euro për blerje të naftës gjithashtu edhe disa mbetje nga shpenzimet komunale i kemi përdorë për blerje të naftës. Te sherbimet kontraktore, siç e dini në vitin e kaluar për herë të parë janë mbajtur lutjet e mëngjesit, dhe një pjesë të shpenzimeve për këtë organizim i ka mbuluar edhe Kuvendi dhe me këtë rast i kemi shpenzuar 33,039 euro. Një pjesë e shërbimeve kontraktore janë edhe angazhimi i ekspertëve prej komisioneve parlamentare. Gjithashtu në këtë shërbim janë shpenzimet e pasqyruara për përkthim në seanca prej gjuhës shipe në gjuhën angleze. Ndërsa te pika 4, te mirëmbajtja e objektit, vitin e kaluar është nënshkruar një kontratë e re për mirëmbajtje të objektit dhe tregu e ka dhënë çmimin e vetë, që ka qenë në vlerë të tregut më të madhe se kontrata e përparshme, po ashtu për mirëmbajtje është edhe aneksi i ndertesës.

Hykmete Bjarami: kërkojë të dijë se shumë prej 107,000 euro për dreka zyrtare a është e saktë dhe nëse është e vërtet atëherë pse keni reaguar ndaj mediave?

Ismet Krasniqi: sqaroi se ne kemi reaguar për mënyrën se si e kanë paraqitur gazetarët një lajm të tillë. Ne kemi një vendim të Kryesisë, që përcakton se reputacioni në emër të kryetarit e ka të definuar pa limit. Të drejtë reprezentacioni kanë deputetët me pozita funksionale, kryetarët e komisioneve, nënkryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare, në administratë sekretari, drejtorët e drejtorive. Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare janë futur edhe shpenzimet për dreka për 17 shkurtin, pastaj drekat të shtruar për delegacione që vinë në Kosovë që shtron kryetari i kuvendit, po ashtu edhe antarët e kryesisë por ka edhe prej komisioneve që ju bëjnë dreka homologëve të tyre. E totali i këtyre shpenzimeve e keni pa është e saktë që është prezantu ajo shifër.

Hykmete Bajrami: unë mendoj se drekat të programi i deputetëve 107,000 euro janë shumë dhe është emërtimi i gabueshëm dhe do të duhej të specifikoheshin këto shpenzime.

Latif Gashi: unë mendoj se më mirë është të ia ndërronit emërtimin këtij shpenzimi dhe mos të thuhet dreka për deputetë sepse nuk munden me hy 120 deputetë, sepse këto janë shpenzime të kryesisë, kryetarëve të komisioneve, grupeve parlamentare, etj. Ju kisha lutur të specifikohen këto shpenzime se për qfarë dhe nga kush shpenzohen.

Muhamet Mustafa: edhe unë jam ndier keq kur kam lexuar gazetën se qfarë ka shkruajtur për Kuvendin. Unë e kuptoj plotësisht arsyetimin e sekretarit, por unë mendoj se kemi një zyrë për informim dhe nuk mjaftohet vetëm me reagim, duhet me e mbajtur një konferencë për shtypë dhe me sqaruar këtë qëshetje. Kështu luhetet kredibiliteti jonë si deputetë.

Kryetarja: thekson se ne si komision për buxhet e financa i kemi në dispozicion 10,000 euro por nuk i kemi shpenzuar ato mjete, sepse na ka ndihmuar GIZ-i në aktivizimin e ekspertëve. Ka qenë mirë me u qartësuar këto gjëra.

Hasime Krasniqi: në vështrimin e këtyre raporteve, ka pasur shumë raste kur ne si deputetë jemi ndier keq. Është rasti të udhëtimet zyrtare, ku mjetet që janë zotue për komisionin tonë, përmes mediave janë përmendur në emrin tim si shpenzime komplete të komisionit, për arsye se në emrin im ka qenë vetëm zotimi, e jo marrja mandej për secilin deputetë. Sekretari ka reaguar ndaj këtyre shkrimeve dhe e ka sqaruar situatën, mirëpo mediat e marrin ashtu siç e shohin. Këto gabime nuk duhet të bëhen edhe në

raport dhe zotimet duhet të shkruhen me secilin emër që i merrë ato mjete. Mendojë që për drekat zyrtare kushdo që e bënë shpenzimin e faturës, të qitet emri i tij në raport.

Alban Fetoshi: dua të bëjë vërejtje për shkak se këtu po shoh dreka zyrtare me vlerë prej 752 euro, dhe për mendimin tim është absurde të ndodh një shpenzim kaq i madh për një drekë zyrtare. Është dashtë që këto shpenzime të specifikohen me emra sepse është shumë e rëndësishme të dihet se kush i ka bërë këto shpenzime. Pra në parim kjo nuk është në rregull që një vend kaq i varfër sic është Kosova dhe me një buxhet kaq të vogël të shpenzohen kaq shumë para. Por është e rëndësishme që edhe raportet financiare të qeverisë të kur të vijnë në kuvend të vijnë të detajuara dhe t'i shqyrtojmë edhe ato raporte. Të shohim nëse ato shpenzime janë në rregull.

Naser Osmani kërkoi sqarime për shpenzimet e karburantit me emrat e atyre që i kanë shpenzuar?

Ismet Krasniqi: sqaroi se shpenzimet për derivate janë si në vijim: kryetari i kuvendit ka në dispozicion dy vetura dhe janë shpenzuar 1,856, vetura e nënkryetarit të parë të kryesisë z. Xhavit Haliti prej 3,671, Sekretari 975, Sabri Hamiti 1,067, Glauk Konjufca 3,457, Petar Miletiç në shumë prej 4,407, vetura me numër 18 është i kshilltarit të kryetarit, me 19 është këshilltarit të kryetarit, vetura me numër 20 është e administratës, vetura me numrin 21 është për deputetë. Tjerat janë për administratën.

Muhamet Mustafa: theksoi se shpenzimet duhet me qenë transparente dhe të hiqen spekulimet dhe të vie në shprehje përgjegjësia individuale. Kërkesa ime precize është që të vijnë në komision të detalizuara informatat për shpenzimet e karburantit, dreka dhe darka zyrtare, shpenzimet e telefonave për të gjithë funksionarët e Kuvendit. Këto informata ti sigurohen komisionit për informim dhe ne të aprovojmë raportin sot.

Latif Gashi të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare, të specifikohen sipas shpenzuesve që i kanë bërë, me emërin e atyre që i kanë bërë shpenzimet.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadergjoni, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Musafa, Hykmete Bajrami, Sevdije Lama dhe Duda Balje), një Kundër (Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

- I. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013.
- II. Kërkohet nga Administrata e Kuvendit, që të dërgojë në Komision për informim, të detalizuara dhe me emra të shpenzuesve: shpenzimet e karburantit, dreka dhe darka zyrtare, shpenzimet e telefonave.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre me amedamentet e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja: njoftoi se nga kryesia e kuvendit e kemi një përfundim që kërkohet nga komisioni për buxhet dhe financa që ta shyrtojn PL me amendamente të propozuara dhe komisioni funksionale ti paraqesin raportet merkomandime deri më 10 mars të viti 2014, në të kundërtën PL do të radhitet në seancë plenare. Grupi punues i komisionit ka mbajtur dje një takim që jemi përpjekur të shyrtojmë dhe ta

analizojmë këtë projektligj. Në deklaratën financiare shuma e këtij PL është dikun 72 milion euro, por që mendojë se vlerësimi i kostos buxhetore nuk është real, sepse duhet të definohen saktë sa janë këta persona që përfitojnë. Në amendamentet e komisionit funksional shifet se janë bërë përmirësime, është paraparë që të formohet një komision qeveritar, i cili do ta bëjë verifikimin e personave të cilët kanë qenë të dhunuar gjatë luftës, në periudhën prej 5 viteve. FMN-ja ka pasur reagime dhe ka sugjeruar të jemi të kujdesshëm. Në si grupi punues kemi mendue me dal me një rekomandimin se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, që do të duhej të parashiheshin në kornizën e ardhshme buxhetore (në KASH dhe në ligjet vjetore të buxhetit të Republikës së Kosovës), brenda periudhës prej pesë vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit.

Hykmete Bajrami: po shqyrtojmë një projektligj ku në deklaratën financiare thuhet se kostoja buxhetore shtesë është 72 milion euro. Është shumë interesant sepse e kemi një projektligj që ende nuk e kemi kaluar në lexim të parë që është Projektligji për Veteranët e Ushtrisë të Çlirimtare të Kosovës që po ashtu ka deklaratën financiare njëjtë prej 72 milion.

Albana Fetoshi: Jam kundër amendamentit të komisionit funksional ku ka kërkuar të fshihet shuma prej 300,00 që përcakton pensionin për personat e dhunur gjatë luftës. Mendoj që nuk është në rregull që të fshihet kjo shumë dhe arsyeja që kjo duhet të rregullohet në akte nënligjore nga qeveria nuk do të thotë asgjë.

Jam kundër këtij amendamenti dhe kërkoj që të hidhet në votim.

Kryetarja: sqaroi se ky projektligj për ndryshim dhe plotësim, ka të bëjë vetëm me personat e dhunuar gjatë luftës, ndërsa kategoritë tjera, rregullohen me ligjin e miratuar më herët.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre, përmban implikime buxhetore shtesë, që do të duhej të parashiheshin në kornizën e ardhshme buxhetore (në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe ligjet vjetore të buxhetit të Republikës së Kosovës), brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- II. Amendamentet e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi: 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj